VENDIM QARKULLUES
Nr. 23, datë 12.7.2019

PËR PËRJASHTIMIN NGA SKEMA DHE REVOKIMIN E CERTIFIKATËS SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË BANKËS NDËRKOMBËTARE TREGTARE SHA, TË PËRTHITHUR NGA BANKA UNION SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 28, pika 1, të nenit 30, pika 1, shkronja "a", të nenit 31, pika 6, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014 "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar, të nenit 7, pika 6, të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 8, pika 3 dhe nenit 9, pika 4 të udhëzimit nr. 3241, datë 18.12.2014 "Për sigurimin e depozitave në banka", të ndryshuar, të nenit 10, pika 6, të nenit 18, pika 2 të Rregullores "Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave", të nenit 24, pika 1, shkronja "k", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 220, pika 3, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 53, datë 3.7.2019 "Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Union sh.a. me Bankën Ndërkombëtare Tregtare sh.a.", me propozim të drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

VENDOSI:

1. Të përjashtojë nga skema e sigurimit të depozitave Bankën Ndërkombëtare Tregtare sh.a. të përthithur nga bashkimi me Bankën Union sh.a.
2. Të revokojë certifikatën e sigurimit të depozitave të Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a. Ngarkohet Banka Union sh.a., që të dorëzojë në Agjenci certifikatën e sigurimit të depozitave të Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a. menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Banka Union sh.a. që të mbajë të veçuara depozitat e siguruara të subjekteve pjesëmarrëse në këtë proces, për një periudhë tre-mujore nga hyrja në fuqi e revokimit të licencës të Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a., që përkon me çregjistrimin e kësaj të fundit si shoqëri e përthithur në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare, shpallet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, si dhe në një gazetë kombëtare.
5. Ngarkohen Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Sektori i Financës dhe Investimeve dhe Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm të njoftojë Autoritetin Mbikëqyrës lidhur me këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me çregjistrimin nga Qendra Kombëtare e Biznesit të Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a. si shoqëri e përthithur.

KRYETAR I AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Donald Duraj